



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.174

27 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 356 datë 16.12.2010	Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Turqisë për njësinë shqiptare që operon nën komandën e forcës turke në Afganistan, brenda fushës së veprimit të operacioneve të Forcës Ndërkombëtare të Ndhmës për Sigurinë (ISAF).....	8917
Ligj nr.10 357 datë 16.12.2010	Për një shtesë në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”	8921
Ligj nr.10 358 datë 16.12.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”	8922
Ligj nr.10 359 datë 16.12.2010	Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar.....	8925
Ligj nr.10 360 datë 16.12.2010	Për disa ndryshime në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.....	8926
Vendim i Kuvendit nr.75, datë 23.12.2010	Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës.....	8926
Dekret nr.6810 datë 16.12.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	8927
Udhëzim i MMPAU nr.5, datë 26.11.2010	Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis.....	8928

Udhëzim i MF dhe RTSH nr.42, datë 23.12.2010	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, të ndryshuar.....	8931
Vendim i ERE nr.103, datë 10.12.2010	Për fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	8931
Vendim i ERE nr.104, datë 10.12.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec – Vlushe” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	8932
Vendim i ERE nr.105, datë 10.12.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec - Vlushe” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	8933
Vendim i ERE nr.106, datë 10.12.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	8934
Vendim i ERE nr.107, datë 10.12.2010	Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitim të statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2011.....	8935
Vendim i ERE nr.108, datë 22.12.2010	Për licencimin e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8935
Vendim i ERE nr.109, datë 22.12.2010	Për licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8936
Vendim i ERE nr.110, datë 22.12.2010	Për licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	8937

LIGJ
Nr.10 356, datë 16.12.2010

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË TURQISË PËR NJËSINË
SHQIPTARE QË OPERON NËN KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN,
BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË OPERACIONEVE TË FORCËS NDËRKOMBËTARE
TË NDIHMËS PËR SIGURINË (ISAF)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Turqisë për njësinë shqiptare që operon nën komandën e forcës turke në Afganistan, brenda fushës së veprimit të operacioneve të Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6827, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

PROTOKOLL

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË TURQISË NË LIDHJE ME NJËSINË SHQIPTARE QË OPERON NËN
KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË
OPERACIONEVE TË FORCËS NDËRKOMBËTARE TË NDIHMËS PËR SIGURINË (ISAF)**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim referuar si “Palët”),

Në zbatim të rezolutave 1386 (2001), 1413 (2002), 1444 (2002), 1510 (2003), 1563 (2004), 1623 (2005), 1662 (2006), 1707 (2006), 1776 (2007), 1833 (2008) e 1890 (2009) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ushtarake Teknike ndërmjet Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF) dhe Administratës së Përkohshme të Afganistanit të datës 4 janar 2002;

Duke mbajtur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktin e Atlantikut të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të bërë në Londër më 19 qershor 1951;

Duke qenë të sigurt se njësia shqiptare, e cila operon në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan (ATTF), do të ndihmojë në forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Palëve, kanë rënë dakord mbi dispozitat në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij protokoll është të përcaktojë parimet dhe detyrimet në lidhje me njësinë shqiptare që operon nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan brenda fushës së veprimit të Operacioneve të Forcës Ndërkombëtare të Ndhmës për Sigurinë.

Neni 2

Fusha e veprimit

Ky protokoll përcakton hollësitë e mbështetjes dhe bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

Neni 3

Autoritetet

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij protokoll janë Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë.

Neni 4

Përkufizime

1. "ISAF" nënkupton forcën ndërkombëtare që kryen operacione të udhëhequra nga NATO-ja në Afganistan, në përputhje me rezolutat 1386 e në vijim të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. "Komanda e Forcës Turke në Afganistan (ATTF)" nënkupton autoritetin që drejton personelin civil/ushtarak, të caktuar ndaj saj në Afganistan brenda fushës së veprimit të ISAF-it.

3. "Njësia shqiptare" nënkupton anëtarët civilë/ushtarakë të Forcave të Armatosura Shqiptare që shërbejnë nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.

4. "Forca Shqiptare e Manovrës" nënkupton forcën luftarake shqiptare që do të operojë në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.

5. "Oficer i lartë shqiptar" nënkupton oficerin, i cili ka gradën më të lartë në njësinë shqiptare që do të operojë në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.

6. "Disiplinë" nënkupton bindjen e pakushtëzuar ndaj urdhrave dhe komandantëve, si edhe përputhshmërinë absolute me ligjin e eprorëve dhe vartësve.

7. Misioni duhet të plotësojë kërkesat e shërbimit dhe t'u nënshtrohet ndalimeve të tij.

8. "Urdhër" nënkupton shprehjen me shkrim, me gojë apo në formë tjetër të kërkesës dhe ndalimit rreth shërbimit.

Neni 5

Parimet dhe përgjegjësitë

1. Njësia shqiptare brenda kuadrit të autoritetit të dhënë nga Komandanti i Forcës Turke në Afganistan (ATTF), mund të vihet në përdorim individualisht, e ndarë, me elemente, ose si një e tërë kur kërkohet në zonat që gjykohet e përshtatshme nga komandanti i Forcës Turke të Batalionit të Motorizuar të Këmbësorisë.

2. Personeli i njësitë shqiptare do të përmbushë misionin e tij nën kontrollin operacional të komandantëve të ATTF-së dhe të Forcës të Batalionit në mbështetje të operacioneve të ISAF-it. Në nivel vendi, njësia shqiptare do të jetë nën autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

3. Shtirja dhe hollësitë e detyrave që duhen përmbushur nga njësia shqiptare, do të përcaktohen nga vetë Palët ose nga personat e autorizuar prej tyre. Përmbushja e këtyre detyrave do

të bëhet në përputhje me “Rregullat e angazhimit” (ROE), të përcaktuara për territorin e misionit në bashkërendim me Komandantin e Forcës Turke në Afganistan.

Neni 6

Çështje që lidhen me personelin

1. Forca Shqiptare e Manovrës do të vendoset si një forcë e përbërë nga personel kontingjent dhe personel ushtarak të përcaktuar nga të dyja Palët e që do të operojë nën komandën e ATTF-së.

2. Personeli i njësisë shqiptare do të mbajë gradat, simbolet dhe flamurin që i përket Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Çështje si pushimet dhe ndryshimi i detyrës për personelin e njësisë shqiptare do të kryhen në përputhje me parimet, të cilave i nënshtrohet edhe personeli i Komandës së ATTF-së.

4. Personeli i njësisë shqiptare do t’i nënshtrohet të Drejtës Ushtarake të Shqipërisë. Sidoqoftë, Komandanti i ATTF-së dhe Komandanti i Batalionit Turk të Këmbësorisë do të përgatitin një “raport vlerësimi” mbi personelin e sipërpërmendur dhe do t’ua përcjellë atë autoriteteve përkatëse ushtarake në Shqipërisë përmes Zyrës së Atasheut të Republikës së Turqisë në Tiranë.

5. Oficeri i Lartë Shqiptar do të jetë përgjegjës për disiplinën e njësisë shqiptare.

6. Në qoftë se komandanti i ATTF-së do të dojë të ndryshojë cilindo nga personeli në njësinë shqiptare për shkak të mungesës së disiplinës, për arsye shëndetësore apo të tjera, personeli përkatës do të zëvendësohet menjëherë.

Neni 7

Parimet logjistike

1. Transportimi i personelit të njësisë shqiptare, që do të shërbejë në Afganistan ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t’u kthyer në Shqipëri do të përballohet nga Pala turke.

2. Armët dhe municionet e njësisë shqiptare do të sigurohen nga Pala shqiptare. Pas mbarimit të misionit, të gjitha pajisjet e dhëna nga Pala turke do të kthehen.

3. Personeli i njësisë shqiptare që shërben në Afganistan do të përdorë mjediset e Komandës së ATTF-së për të plotësuar nevojat e tyre për komunikim. Komunikimi zyrtar do të sigurohet pa pagesë. Sidoqoftë, shpenzimet vetjake për komunikim do të përballohen nga personeli.

4. Personeli i njësisë shqiptare që shërben në Afganistan do të përfitojë nga shërbimet shëndetësore, duke u bazuar mbi të njëjtat parime, si edhe personeli i Komandës së ATTF-së.

5. Në rast gjendje krize, në operacione ose në zonën e operacioneve, nëse është e nevojshme që të evakohen forcat, Pala turke do të sigurojë evakuim për personelin e njësisë shqiptare.

6. Në rast të plagosjeve të rënda dhe humbjes së jetës, Pala turke do të sigurojë transportim për në Tiranë për personelin e njësisë shqiptare.

Neni 8

Çështjet ligjore

1. Personeli i njësisë shqiptare do t’i nënshtrohet gjatë gjithë kohës dhe në çfarëdo rrethanash ekskluzivisht elementëve të juridiksionit të autoriteteve të tyre kombëtare për shkeljet civile, administrative, penale ose disiplinore dhe këto raste do të administrohen nga Policia Ushtarake Shqiptare. Në çdo rast, do të njoftohet menjëherë Komandanti i ATTF-së.

2. Pretendimet ndërmjet Palëve do të trajtohen në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 7 të NATO-SOFA.

Neni 9
Çështjet financiare

1. Sigurimet financiare: Shpenzimet ditore të njësisë shqiptare në lidhje me ushqimin dhe shërbimin do të përballen nga Pala turke.

2. Pala shqiptare do të jetë përgjegjëse për dëmshpërblim të dëmeve dhe humbjeve të shkaktuara nga personeli i njësisë shqiptare.

3. Pala turke do të paguajë një dietë ditore për personelin e njësisë shqiptare si vijon: 24 dollarë amerikanë për oficerët, 22 dollarë amerikanë për NCO dhe për personelin civil, si edhe 5 dollarë amerikanë për çdo ushtar.

4. Përveç ushqimit dhe strehimit, asnjë shumë nuk do t'i paguhet personelit shqiptar gjatë qëndrimit të tyre në Turqi.

Neni 10
Çështjet e stërvitjes

Njësia shqiptare do të marrë pjesë në programet stërvitore në lidhje me operacionin ISAF nga Komanda e ATTF-së gjatë detyrave të saj në kuadrin e ISAF-it.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Cilado mosmarrëveshje mbi interpretimin ose zbatimin e këtij protokoll do të zgjidhet vetëm përmes këshillimit ndërmjet Palëve dhe nuk do t'i referohet asnjë pale të tretë apo gjykatë ndërkombëtare apo arbitrazhi ndërkombëtar.

Neni 12
Ndryshimi dhe rishikimi

Cilado Palë mund të propozojë me shkrim që të ndryshohet ose rishikohet ky Protokoll, siç mund të kërkohet. Në këtë rast, negociatat do të fillojnë të paktën brenda 30 ditëve nga data e njoftimit me shkrim. Nëse Palët nuk kanë asnjë rezultat nga negociatat brenda 30 ditëve, ky protokoll mund të përfundojë sipas dispozitës së nenit 13 (kohëzgjatja dhe përfundimi).

Neni 13
Kohëzgjatja dhe përfundimi

Ky protokoll do të mbetet në fuqi gjatë gjithë periudhës së kohës në të cilën njësia shqiptare do të kryejë misione bashkërisht me ATTF-në gjatë gjithë operacionit të ISAF-it. Ky protokoll do të përfundojë automatikisht kur të mbarojë misioni i ISAF-it ose në ditën e 30-të pas mbërritjes së njoftimit të përfundimit nga njëra Palë te Pala tjetër. Veç kësaj, Palët kanë të drejtë të përfundojnë këtë protokoll në çdo kohë me pëlqimin e tyre të ndërsjellë. Pretendimet e ndërsjella për dëmshpërblime të Palëve dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga problemet që dalin gjatë gjithë veprimtarisë, përjashtohen nga ky qëllim.

Neni 14
Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë me anë të të cilit Palët do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për plotësimin e procedurave të ratifikimit sipas legjislacioneve përkatëse.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll “Protokoll ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë në lidhje me Forcat Ushtarake Shqiptare që operojnë nën Komandën Turke brenda fushës së veprimit të Forcës Ndërkombëtare të Ndhmës për Sigurinë në Afganistan”, i nënshkruar në Tiranë më 3 nëntor 2003, do të përfundojë.

Neni 15
Teksti dhe nënshkrimi

Bërë më 30.7.2010 në dy kopje origjinale, secila në shqip, turqisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstet njëjloj të barasvlershme. Në rast mosmarrëveshesh në lidhje me interpretimin, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë

Vladimir Avdiaj
Kolonel

Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe
Stërvitjes në SHPFA

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë

Saim Bağcı

Hv.Svn.Kur.Alb

Tiran As.Atş.ve As.İşb. ve Koor Krl.Bşk

LIGJ
Nr.10 357, datë 16.12.2010

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10 171, DATË 22.10.2009 “PËR PROFESIONET E
RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pas shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:
“g) mësuesit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6828, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 358, datë 16.12.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9695, DATË 19.3.2007 “PËR
PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 5 pika 3, pas fjalës “përfaqësues” shtohen fjalët “të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil”.

Neni 2

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Të ardhurat e Komitetit

1. Burimet e financimit të Komitetit janë:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
- c) financime të tjera të ligjshme, të marra nga burime të ndryshme.

2. Tarifa për shërbimet, ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë e të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “ii” të pikës 1, fjalët “6-mujore” zëvendësohen me fjalët “3-mujore”.
2. Fjalja e dytë e pikës 2 riformulohet si më poshtë:

“Kur vihen re shkelje të detyrimeve ligjore në procedurën e birësimit, kryetari i Komitetit i propozon:

- a) autoritetit shtetëror përgjegjës masa disiplinore për drejtuesit apo punonjësit e institucionit shtetëror të përkujdesjes sociale;
- b) Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar heqjen e licencës për institucionet private të përkujdesjes shtetërore.”.

Neni 4

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 12 shfuqizohet.
2. Në pikën 16 fjala “merr” zëvendësohet me fjalën “propozon”.

Neni 5

Në nenin 14, në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky rregull zbatohet edhe kur shtetasi shqiptar ka lidhur martesë me një shtetas të huaj apo person pa shtetësi.”.

Neni 6

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 fjalët “certifikatën e lindjes” zëvendësohen me fjalët “kopjen e letërnjoftimit”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Deklaratën për fëmijërinë, mënyrën e rritjes, edukimin dhe profesionin.”.

3. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Deklaratën me të dhënat për gjendjen ekonomike dhe sociale.”.

4. Në fund të nenit shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Të dhënat, që do të përfshihen në deklaratat e parashikuara në pikat 5, 9 dhe 11 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komitetit Shqiptar të Birësimit. Deklaratat përpilohen përpara noterit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar. Në rastin e përpilimit të këtyre deklaratave jashtë shtetit, ato paraqiten të legalizuara.”.

Neni 7

Në nenin 22 pika 2 shkronja “d”, fjala “certifikatat” zëvendësohet me fjalët “kopje të letërnjoftimit”.

Neni 8

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Agjencitë ndërmjetësuese në fushën e birësimit

1. Agjencitë ndërmjetësuese vendase licencohen sipas legjislacionit për licencat, për një afat 5-vjeçar, dhe në licencë përcaktohen territori dhe shtetet, për të cilat do të ndërmjetësojnë. Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.3 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Agjencitë ndërmjetësuese të huaja njihen dhe miratohen nga komisioni i miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për një afat 5-vjeçar për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Përbërja dhe rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i komisionit për njohjen dhe miratimin e ushtrimit të veprimtarisë dërgohet për publikim në Qendrën Kombëtare të Licencimit brenda 10 ditëve. Nëse komisioni rrëzon kërkesën, agjencia ndërmjetësuese ka të drejtë që, brenda 10 ditëve, të paraqesë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, i cili shprehet me vendim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Agjencitë ndërmjetësuese, vendase ose të huaja, duhet:
- a) të ndjekin vetëm qëllime jofitimprurëse, sipas kushteve të përcaktuara nga Komiteti;
 - b) të drejtohen dhe të kenë personel me integritet moral dhe të kualifikuar në fushën e birësimit, me punonjës socialë, psikologë dhe juristë;
 - c) të sigurojnë një administrim kontabël, transparent, për kostot e domosdoshme për realizimin e procedurës së birësimit;
 - ç) të mos paragjykojnë dhe të mos diskriminojnë aplikantët birësues, për shkaqe të tilla, si raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike e filozofike apo shkaqe të tjera diskriminuese;
 - d) të jenë regjistruar në gjykatë.”.

Neni 9

Në nenin 34, pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) të paraqesin pranë Komitetit raporte me shkrim çdo 6 muaj për veprimtarinë e tyre dhe në çdo rast që Komiteti i kërkon një raport të tillë.”.

Neni 10

Në titullin e kreut VII, fjala “dokumentacionit” zëvendësohet me fjalët “të dhënave personale”.

Neni 11

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Komiteti respekton dhe përgjigjet për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës në procedurat e birësimit. Ai merr masat organizative dhe teknike të domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave personale, duke zbatuar kushtet, kriteret dhe procedurat për përpunimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëse gjatë procedurave të birësimit lind nevoja për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për një veprim të caktuar, kryetari i Komitetit paraqet kërkesë me shkrim.

3. Agjencitë ndërmjetësuese vendase, në cilësinë e kontrolluesit, detyrohen të zbatojnë të gjitha kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Punonjësit publikë dhe privatë që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, vihen në dijeni për të dhënat e përpunuara dhe kanë informacion për birësim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna nuk mund të përhapen apo bëhen të ditura, përveç rasteve të parashikuara me ligj.”.

Neni 12

Në fund të nenit 38 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Komiteti, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masat për:

- a) paraqitjen pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit të informacionit të nevojshëm të agjencive ndërmjetësuese të licencuara prej tij përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- b) depozitimim pranë Ministrisë së Drejtësisë të kërkesave për licencë dhe të dokumentacionit shoqërues, të paraqitura nga agjencitë ndërmjetësuese përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat Komiteti nuk ka vendosur ende;

c) depozitimin e të dhënave të agjencive ndërmjetësuese të licencuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për qëllime të regjistrimit, sipas pikës 4 të nenit 33 të këtij ligji.

Ministri, që përfaqësohet në këshillin drejtues të Komitetit Shqiptar të Birësimit, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masa për caktimin e përfaqësuesit, në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të këtij ligji.”.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6829, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 359, datë 16.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7918, DATË 13.4.1995 “PËR MIRATIMIN ME
NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 “PËR EMETIMIN DHE
SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)” DHE
DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1030,
DATË 23.2.1995”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Fjalja e fundit e nenit 3 të ligjit nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Afati i përdorimit të bonove dhe të lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2011”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6830, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 360, datë 16.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 119, DATË 23.4.2009 “PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 92 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1, fjalët “jo më vonë se data 15 janar 2011” zëvendësohen me fjalët “jo më vonë se data 30 shtator 2011”.

2. Në pikën 3 fjalët “në datën 15 janar 2011” zëvendësohen me fjalët “në datën 30 shtator 2011”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6831, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr.75, datë 23.12.2010

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE NË KOMUNAT DHE BASHKITË NË QARKUN E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 174 pika 2 dhe 78 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shpallur me vendimin nr. 968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në komunat dhe bashkitë e qarkut Shkodër”.

II. Ky vendim hyn në fuqi në datën 30.12.2010.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6810, datë 16.12.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ada Bardhyl Paja Sejersgaard-Jacobsen (Paja)
2. Aiyana Çollaku
3. Alket Hilmi Zeqo
4. Alma Bardhyl Çeku
5. Arissa Çollaku
6. Avni Remzi Sulejmani
7. Besmira Ibrahim Herrmann (Ferhati)
8. Bruno Ylli Pelushi
9. Christian Hysni Çeku
10. Denada Myslim Çollaku
11. Diana Zef Babel (Meshi)
12. Edlira Ramazan Guza (Dashi)
13. Gani Elez Manaj
14. Heloisa Ibrahim Blakshtori
15. Kelta Skënder Basha
16. Leonie Alket Zeqo
17. Lorenc Xhafer Hysenaj
18. Luljeta Dervish Schlobohm (Ali)
19. Matilda Fatmir Devollaj
20. Mirlinda Fatmir Heidorn (Xhaferrri)
21. Nertila Avenir Sadikaj
22. Pranvera Dalip Paradeiser (Lleshi)
23. Riselda Leonard Ritter (Bandilli)
24. Sebastian Anton Bytyçi (Bytyci)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr.5, datë 26.11.2010

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME LEJE TË THJESHTË
MJEDISORE TË VEPRIMTARIVE QË LËSHOJNË ZHURMA NË MJEDIS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”,

UDHËZOJ:

1. Me qëllim shmangien, minimizimin dhe kontrollin e efekteve të dëmshme të zhurmës në qetësinë publike dhe mjedis, veprimtaritë ekonomike që lëshojnë zhurmë do t’i nënshtrohen pajisjes me leje të thjeshtë mjedisore (të tipit III 1/A, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL)”) në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

2. Veprimtaritë që lëshojnë zhurmë në mjedis dhe që duhet t’i nënshtrohen zbatimit të këtij udhëzimi listohen në shtojcën I bashkëlidhur.

3. Për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore (autorizim mjedisor), subjekti fizik apo juridik që kërkon të ushtrojë veprimtarinë paraqet pranë QKL-së këto dokumente:

- a) Ekstraktin e regjistrimit të subjektit pranë QKR-së;
- b) Përshkrimin e objektit ku do të ushtrohet veprimtaria shoqëruar me adresën, planvendosjen dhe fotografi;
- c) Projektin teknik ku të jepet informacion për llojin e veprimtarisë që synon të zhvillojë shoqëruar me planimetrinë e objektit ku do të ushtrohet veprimtaria, të dhëna për burimet e zhurmës si pajisjet/aparaturat e instaluar që lëshojnë zhurmë, si dhe vlerën teknologjike përkatëse të lëshimit të zhurmës, distancën me objektet e tjera dhe pozicionimin e tyre në raport me vendndodhjen e veprimtarisë dhe informacion për kohëzgjatjen e orarit e punës që kërkohet të zbatohet;
- d) Raport për nivelet e pritshme të zhurmës që do të çlirohen në mjedis nga veprimtaria (matja të bëhet në kapacitet të plotë të teknologjisë së instaluar që çliron zhurmë), hartuar nga Instituti i Shëndetit Publik;
- e) Faturën e tarifës së shërbimit prej 10 000 lekësh që paguhet për llogari të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në Raiffeisen Bank;
- f) Mendimin e njësisë së qeverisjes vendore ku të shprehet opinioni për zhvillimin e veprimtarisë;
- g) Një procesverbal ku të tregohet që janë konsultuar dhe është marrë mendimi i banorëve pranë vendit ku do të zhvillohet veprimtaria;
- h) Një deklaratë të subjektit që do të respektojë oraret e qetësisë publike dhe të lejes së thjeshtë mjedisore.

4. Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit brenda 2 ditëve pas marrjes së dokumentacionit të aplikimit nga QKL-ja e përcjell atë elektronikisht për shqyrtim pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) në qarkun përkatës.

5. ARM-ja brenda 3 ditëve nga marrja e informacionit bën verifikimin e objektit dhe në përfundim harton një relacion për rezultatet e verifikimit.

6. Në përfundim të shqyrtimit ARM-ja vendos:

- a) Miratimin e lejes së thjeshtë mjedisore duke i detajuar në të edhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit nga zhurmat në përputhje me formatin e Shtojcës II;
- b) Refuzimin e kërkesës duke dhënë arsyet për këtë vendim;

7. ARM-ja miraton me leje të thjeshtë mjedisore (autorizim mjedisor) vetëm veprimtaritë që sigurojnë zbatimin e normave të lejuara të zhurmës në mjedis dhe garantojnë qetësinë publike në përputhje me aktet ligjore përkatëse.

8. ARM-ja brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, sipas pikës 6, përcjell pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit aktin e miratimit/refuzimit, e cila e dërgon menjëherë pranë QKL-së.

9. ARM-ja brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit informon me shkrim njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) ku do të ushtrohet veprimtaria, duke i bërë të ditur vendimin e marrë, si dhe kushtet që duhet të zbatohet subjekti për mbrojtjen e mjedisit dhe qetësisë publike nga zhurmat.

10. Afati kohor brenda të cilit ARM-ja bën shqyrtimin dhe merr vendim për kërkesën është 8 ditë nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit.

11. Në rast se ARM-të kanë nevojë për asistencë teknike (për zhurmat) konsultohen me Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, e cila angazhohet dhe jep kontributin e saj pa vonesë.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit në qarqe dhe Inspektorati i Mjedisit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

SHTOJCA I LISTA E VEPRIMTARIVE

1. Lokalet e natës/veprimtaritë e specializuara të argëtimit që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në qendrat e banuara.

2. Furrat e prodhimit të bukës që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në mjediset e banuara.

3. Serviset e automjeteve, gomisteritë dhe pikat e larjes së automjeteve që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në qendrat e banuara.

4. Punishtet/veprimtaritë e saldimit të metaleve që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në mjediset e banuara.

5. Veprimtaritë e prodhimit/përpunimit të duraluminit që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në mjediset e banuara.

6. Veprimtaritë e përpunimit të mermerit dhe gurëve dekorativë që gjenden në zonat e banuara ose çlirojnë zhurmë që ndikojnë në mjediset e banuara.

7. Veprimtaritë e prodhimit të mobilieve në zonat urbane/në brendësi të qendrave të banuara.

8. Veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjeneratorë/ventilatorë, të cilët lëshojnë zhurmë në mjediset e hapura të zonave të banuara.

9. Nyjat e fraksionimit të mineraleve, në rast se gjenden brenda zonave të banuara ose çlirojnë zhurma që ndikojnë në zonat e banuara.

10. Prodhimi i betonit, llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, blloqeve, paletave etj.), në rast se gjenden brenda zonave të banuara ose çlirojnë zhurma që ndikojnë në zonat e banuara.

11. Punishtet e pijeve alkoolike, produkteve shtazore dhe bimore, në rast se gjenden brenda zonave të banuara ose çlirojnë zhurma që ndikojnë në zonat e banuara.

SHTOJCA II
FORMATI I AUTORIZIMIT MJEDISOR
(leje e thjeshtë mjedisore)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Agjencia Rajonale e Mjedisit e Qarkut _____
Adresatel.....

Nr. Prot.

Data200.....

Nr. Identifikues ____

Nr. i vendimit ____

AKTMIRATIMI
AUTORIZIM MJEDISOR
Për veprimtari që lëshojnë zhurmë në mjedis

Në mbështetje të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis miratohet autorizimi mjedisor:

Veprimtarisë:
Subjektit:
Vendndodhja:.....

Veprimtaria do të zhvillohet me këto kushte dhe kërkesa:

1. lista dhe lloji i pajisjeve që lëshojnë zhurmë;
2. oraret dhe vlerat e lejuara të çlirimit të zhurmës;
3. masat për kufizimin e zhurmës, mbrojtjen e mjedisit dhe qetësisë publike nga zhurmat;
4. kërkesat për vetmonitorimin/matjet e zhurmës (periodike) dhe raportimi i të dhënave;
5. kërkesën për afishimin e orareve të punës për të cilët miratohet leja e thjeshtë mjedisore;
6. sanksionet e mundshme në rast të mosrespektimit të kushteve të lejes së thjeshtë mjedisore;
7. tarifa e autorizimit mjedisor.

Nënshkrimi

UDHËZIM
Nr.42, datë 23.12.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE TELEVIZIVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive” të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive është 100 (njëqind) lekë në çdo muaj kalendarik”.

2. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Me vjeljen e kësaj tarife ngarkohen zyra e pagesës së energjisë elektrike. Vjelja e kësaj tarife bëhet çdo muaj”.

3. Pika 4 riformulohet:

“4. Faturat tatimore të energjisë elektrike të “CEZ Shpërndarje” do të kenë në fund, si një zë më vete, tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave nr.17/4, datë 26.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

4. Pika 6 e udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6. Pagesat e tarifës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike, ku shënohet “tarifa e paguar për muajin _____, data e pagesës, si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj tarife.”

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
Petrit Beci

VENDIM
Nr.103, datë 10.12.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“FAVINA 1” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 pika 5 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” dhe nenit 37 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., si dhe

relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi rinovimin e licencës në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike (neni 16, pika 1, germa “d”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.104, datë 10.12.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC – VLUSHE” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec – Vlushe” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec – Vlushe” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec – Vlushe” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec – Vlushe”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.105, datë 10.12.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HEC - VLUSHE” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1 germa “a”, dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec - Vlushe” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec - Vlushe” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hec - Vlushe” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të en/elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.106, datë 10.12.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORKIS-2009”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Korkis-2009” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Belesova 1” dhe “Belesova 2”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.107, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 48 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe ligjit nr.9501 datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. Për vitin 2011, të gjithë klientët tariforë (familjarë dhe jofamiljarë) të energjisë elektrike kanë të drejtë të përfitojnë statusin e klientit të kualifikuar pavarësisht nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.108, datë 22.12.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “YLLIAD” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8, 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.109, datë 22.12.2010

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8, 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e tregimit të energjisë elektike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.110, datë 22.12.2010

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a”, neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike nga “Hec Pobreg” me fuqi 9MW, për një periudhë 30-vjeçare.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 27.12.2010

Doli nga shtypi më 27.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë